

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Nr.4 Tiranë

PROGRAMI

I KURSIT TË VEÇANTË

“KUJDESTARI PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR”

Kodi: KPAK-21

Miratoi

DREJTOR

.....

Tiranë, 2021

PROGRAMI I KURSIT TË VEÇANTË

“KUJDESTARI PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR”

(Kodi: KPAK-21)

I. Profili profesional i kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar.

a) Karakteristikat kryesore të kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar.

Kujdestari për të personat me aftësi të kufizuar do të jetë i aftë të kryejë detyra që lidhen me kujdesin personal dhe social të personave me aftësi të kufizuar pranë institucioneve shtetërore ose private që ofrojnë shërbime sociale, ose shërbime të kujdesit personal në shtëpi. Kujdestari për personat me aftësi të kufizuar, do të angazhohet në shërbime apo detyra që e ngarkojnë atë jo vetëm me përgjegjësi të madhe individuale, por edhe me përdorimin e shprehive specifike intelektuale për të zbatuar në mënyrë sa më konkrete dhe korrekte programe të përkujdesjes psiko-sociale dhe personale.

Për realizimin me sukses të detyrave të mësipërme, kujdestari për personat me aftësi të kufizuar duhet të zotërojë njohuri që kanë të bëjnë me etikën profesionale, me respektimin e të drejtave të njeriut, me standartet e shërbimeve sociale, me konceptet bazë të legjislacionit të shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuar etj., por jo vetëm, kujdestari për personat me aftësi të kufizuar duhet të zotërojë shprehje profesionale që kanë të bëjnë me: ndihmën e parë, me mbështetjen për përmbushjen e nevojave psiko-sociale, me zbatimin e procedurave të përkujdesjes personale, me dhënien e medikamenteve, shoqërimin e etj., individëve me aftësi të kufizuar.

Suksesi i kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar është i lidhur ngushtë dhe me sjellje (qendrim) të tilla si: empatia, të qenit i disiplinuar, i ndershëm, i durueshëm, i vetëkontrolluar, i kujdesshëm, korrekt dhe të ketë aftësi të mira komunikimi etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar.

Profesioni i kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar është i lidhur ngushtë meshërbimet sociale ndaj individëve me aftësi të kufizuar, të cilat kryhen në institucione shtetërore ose private që ofrojnë keto shërbime, ose shërbime që ofrojnë kujdes personal në shtëpi. Kështu që, kujdestari për personat me aftësi të kufizuar mund të punësohet në qendra komunitare të shëndetit mendor dhe fizik, qendra komunitare për të moshuar, qendra ditore për kujdesin e fëmijëve me aftësi të kufizuar, institucione të kujdesit për fëmijë jetim, shoqata, organizata, etj., që mbështesin personat me aftësi të kufizuar. Gjithashtu, kujdestari për personat me aftësi të kufizuar mund të punësohet në shërbime pranë familjeve që janë të interesuar për kujdesin e familjarëve të tyre me aftësi të kufizuar. Kujdestari për personat me aftësi të kufizuar mund të vetëpunësohet, duke krijuar biznesin social, duke punësuar kështu dhe të tjerë, sigurisht që kjo kërkon kualifikime të mëtejshme dhe eksperiencë profesionale. Kujdestari për personat me aftësi të kufizuar i ka mundësitë për të përparuar në profesion duke kaluar në faza të ndryshme, ai/ajo mund të angazhohet me sukses dhe në fusha të përafërta, si infermieri, ose punonjës social etj., sigurisht që këto kërkojnë përvojë pune dhe arsimim e trajnim të vazhdueshëm.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Kujdestari për personat me aftësi të kufizuar”.

Në përfundim të Kursit për Kujdestari për personat me aftësi të kufizuar, kursantët do të jenë të aftë :

- të zbatojnë etikën profesionale të kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar;
- të respektojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuar;
- të përshkruajnë shërbimet dhe procedurat ligjore për personat me aftësi të kufizuar në Shqipëri.
- të respektojnë rregullat specifike të komunikimit me personat me aftësi të kufizuar;
- të përshkruajnë aspektet sociale dhe nevojat e individëve me aftësi të kufizuar;
- të mbështesin përmbushjen e nevojave psiko-sociale të personave me aftësi të kufizuar sensore, mendore dhe fizike;
- të kujdesen për shëndetin mendor të PAK-Fizik dhe PAK-Mendor;
- të orientojnë PAK-Pamor për lëvizjet me përcjellës dhe prekje sensore;
- të kujdesen për përmbushjen e nevojave personale të PAK –Pamor;
- të kujdesen për ushqyerjen, dietën, veshjen dhe higjienën personale të PAK - Mendor.
- të kujdesen për ushqyerjen, veshjen dhe higjienën personale të PAK –Fizik;
- të japin PAK-Mendor dhe PAK-Fizik medikament e rekomanduara;
- të zbatojnë gjimnastikën dhe procedurat e rekomanduara në varësi të aftësisë së kufizuar fizike.
- të japin ndihmën e parë individëve me aftësi të kufizuar, në varësi të rrezikut të mundshëm;
- të zbatojnë rregullat e higjienës dhe të mjedisit gjatë përkujdesjes personale të PAK;
- të ndërtojnë marrëdhënie profesionale me familjarët e personave me aftësi të kufizuar;
- të përcaktojnë rolin dhe përkujdesjen e PAK në shërbimet familjare.
- të përkujdesen për personat me aftësi të kufizuar në banesë, pranë familjeve;
- të zbatojnë rregullat e etikës profesionale.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin “Kujdestari për personat me aftësi të kufizuar”.

Pjesëmarrësit në Kursin për “Kujdestari për personat me aftësi të kufizuar”, duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 18 vjeç.

IV. Kohëzgjatja e Kursit “Kujdestari për personat me aftësi të kufizuar”.

250 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit “Kujdestari për personat me aftësi të kufizuar”.

Nr	Titulli i Modulit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
----	-------------------	------	-------------	---------------------

1	Hyrje në profesionin e kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar.	KPAK-01-21	40 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të kujdestarit për PAK. 2. Kursanti përcakton rolin, rëndësinë dhe detyrat e kujdestarit PAK. 3. Kursanti përshkruan shërbimet dhe procedurat ligjore për PAK në Shqipëri. 4. Kursanti respekton rregullat e komunikimit me PAK.
2	Kujdestari për personat me aftësi të kufizuar sensore.	KPAK-02-21	60 orë mësimore Rekomandohet: 30% Teori 60% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan aftësinë e kufizuar sensore(pamore dhe dëgjimore). 2. Kursanti mbështet përmbushjen e nevojave psiko-sociale të PAK-Sensor. 3. Kursanti orienton PAK-Pamor për lëvizjet me përcjellës dhe prekje sensore. 4. Kursanti kujdeset për përmbushjen e nevojave personale të PAK -Pamor.
3	Kujdestari për personat me aftësi të kufizuar mendore	KPAK-03-21	70 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan aftësinë e kufizuar mendore. 2. Kursanti mbështet përmbushjen e nevojave psiko-sociale të PAK-Mendor. 3. Kursanti kujdeset për shëndetin mendor të PAK-Mendor. 4. Kursanti kujdeset për ushqyerjen, dietën, veshjen dhe higjienën personale të PAK -Mendor. 5. Kursanti ndihmon PAK-Mendor për marrjen e medikamenteve të rekomanduara nga mjeku.
4	Kujdestari për personat me aftësi të kufizuar fizike.	KPAK-04-21	80 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan aftësinë e kufizuar fizike. 2. Kursanti mbështet përmbushjen e nevojave psiko-sociale të PAK-Fizik. 3. Kursanti përkujdeset për shëndetin mendor të PAK-Fizik. 4. Kursanti kujdeset për ushqyerjen, veshjen dhe higjienën personale të PAK -Fizik. 5. Kursanti zbaton gjimnastikën dhe procedurat e rekomanduara në varësi të aftësisë së kufizuar fizike. 6. Kursanti ndihmon PAK-Fizik për marrjen e medikamenteve të rekomanduara nga mjeku.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për “Kujdestari për personat me aftësi të kufizuar”:

1. Moduli “Hyrje në profesionin e kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E KUJDESTARIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR.	KPAK-01-21
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me rolin dhe veçoritë e kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar, me përfshirjen e tij në shërbimet sociale, familjare, komunitare, me identifikimin e shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuar, si dhe me respektimin e rregullave të komunikimit.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar. Të jenë mbi 18 vjeç.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të kujdestarit për PAK. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë të: - përshkruajë veçoritë e punës së kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar; - përshkruajë karakteristikat e punës së kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar; - përshkruajë mundësitë e punësimit të kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar; - përshkruajë mundësitë e karrieres së kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar; - të përshkruajë rregullat e etikës profesionale të kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë - Pyetje - përgjigje me shkrim RM 2 Kursanti përcakton rolin, rëndësinë dhe detyrat e kujdestarit PAK. Kriteret e vlerësimit Kursanti duhet të jetë i aftë të: - përshkruajë tiparet e kujdestarit për personave me aftësi të kufizuar; - përcaktojë rolin e kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar; - të përshkruajë të drejtat dhe detyrat e kujdestarit për	

- personat me aftësi të kufizuar;
- listojë detyrat e kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar;
- përcaktojë rëndësinë e rolit të kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar në shoqëri;
- të përcaktojë nevojat specifike për çdo aftësi të kufizuar;
- të përshkruajë llojet e përkujdesjes për çdo aftësi të kufizuar;
- përshkruajë rregullat e marrëdhënies së kujdestarit me personat me aftësi të kufizuar;
- përshkruajë rregullat e komunikimit dhe sjelljes me familjarët e personave me aftësi të kufizuar;
- përshkruajë rëndësinë e empatisë gjatë ushtrimit të profesionit;
- respektojë diversitetin dhe konfidencialitetin e individëve me të cilët punon;
- përshkruajë mënyrën e sjelljes dhe qëndrimit të kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 3 Kursanti përshkruan shërbimet dhe procedurat ligjore për PAK në Shqipëri.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- përkufizojë aftësinë e kufizuar sipas legjislacionit shqiptar;
- përshkruajë konceptet bazë të legjislacionit shqiptar në mbrojtje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar;
- identifikojë tipologjinë e shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuar;
- evidentojë funksionet e shërbimeve rezidenciale publike dhe private, organizata, shoqata për kujdesin e personave me aftësi të kufizuar;
- evidentojë shërbimet në shtëpi dhe rolin e kujdestarit në këtë lloj shërbimi;
- të përshkruajë standartet e shërbimeve sociale në vendin tonë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 4 Kursanti respekton rregullat e komunikimit me PAK.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- respektojë të drejtat e personave me aftësi të kufizuar;
- respektojë etikën e komunikimit me personat me aftësi të kufizuar;
- përdorë empatinë gjatë komunikimit me personat me aftësi

- të kufizuar;
- trajtojë sipas moshës dhe statusit social personat me aftësi të kufizuar;
- përshtatet me statusin social të personave me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike;
- respektojë rregullat e komunikimit me familjarët e personave me aftësi të kufizuar;
- respektojë intimitetin dhe dinjitetin e personave me aftësi të kufizuar gjatë shërbimeve personale higjienike;
- menaxhojë sjelljet e personave me aftësi të kufizuar, veçanërisht mendore;
- ndërtojë marrëdhënie korrekte dhe humane me personat me aftësi të kufizuar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin e kursit Kujdestar për personat me aftësi të kufizuar, si dhe të organizohen vizita pranë qendrave rezidenciale dhe ditore të cilat ofrojnë shërbime social-komunitare.
- Instruktori duhet të përfshijë sa më shumë të jetë e mundur kursantin në demonstrimin konkret të çështjeve që trajton.
- Instruktori duhet të krijojë kushtet sa më të përshtatshme në mënyrë që të stimulojë angazhimin e kursantëve.
- Kursanti duhet të angazhohet sa më shumë në veprimtari konkrete për të përshkruar shërbimet, nevojat social-komunitare personave me aftësi të kufizuar në të cilat bazohet aktiviteti i kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
 - Mjedis për zhvillimin e orëve teorike.
 - Video-projektor.
 - Modele të ndryshme të katalogëve që promovojnë shërbime sociale.
 - Materiale didaktike, udhëzuesat, rregullore, etj.
-

2. Moduli “Kujdestari për personat me aftësi të kufizuar sensore”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	KUJDESTARI PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR SENSORE.	KPAK-02-21
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i aftëson kursantët për përmbushjen e nevojave psiko-sociale të PAK-Sensor, për të orientuar PAK-Pamor për lëvizjet me përcjellës dhe prekje sensore, si dhe për fitimin e autonomisë për lëvizje dhe vetëshërbim, të personave me aftësi të kufizuar sensore pranë familjeve, qendrave ditore dhe rezidenciale.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 30% Teori; 60% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar. Të jenë mbi 18 vjeç. Të kenë përfunduar Modulin 1 “Hyrje në profesionin e kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan aftësinë e kufizuar sensore (pamore dhe dëgjimore). Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë të: - përkufizojë aftësinë e kufizuar sensore; - bëjë dallimin midis aftësisë së kufizuar pamore dhe dëgjimore; - përshkruajë problematikat e aftësisë së kufizuar sensore; - përshkruajë rregullat e komunikimit me personat me aftësi të kufizuar pamore; - shpjegojë proceset e punës dhe detyrat për orientimin dhe mobilitetin e PAK-Pamor; - shpjegojë rëndësinë e perceptimit dhe motorikës në punën me PAK –Pamor; - përshkruajë teknikat për orientim dhe mobilitet të PAK-Pamor; - përshkruajë rregullat e komunikimit me personat me aftësi të kufizuar dëgjimore; - shpjegojë proceset e punës për mobilitetin e PAK-Dëgjimor; - përshkruajë rregullat e daktilimit për komunikimin me PAK-Dëgjimor; - përcaktojë kërkesat dhe nevojat e PAK-dëgjimor, përshtatja me to; - zbatojë rregullat specifike të komunikimit me PAK-sensore; - përshkruajë rrreziqet e mundshme që mund të rezikojnë jetën e PAK-Sensor;	

-
- përshkruajë rregullat dhe procedurën për ndihmën e parë në rast rreziku;
 - zbatojë rregullat e etikës profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje- përgjigje me gojë
- Pyetje –përgjigje me shkrim

RM 2 Kursanti mbështet përmbushjen e nevojave psiko-sociale të PAK-Sensor.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të

- kryejë vëzhgimin e PAK-Sensor;
- njohë drejtpërdrejtë PAK-sensor;
- mbrojë nga paragjykimi dhe diskriminimi PAK-Sensor;
- kryejë vëzhgimin sistematik të PAK-Sensor;
- planifikojë përkujdesjen psiko-sociale sipas rasteve përkatëse;
- vlerësojë nevojat për autonomi për PAK-Sensor;
- vlerësojë nevojat sociale të PAK Sensore;
- vlerësojë nevojat psikologjike të PAK Sensore;
- vlerësojë nevojat për shoqërizim të PAK Sensore;
- nxisë marrjen e vendimeve rreth jetës së përgjithshme dhe aktiviteteve të PAK-Sensor;
- asistojë në nxitjen e fleksibilitetit gjatë rutinës së përditshme të PAK-Sensore;
- planifikojë organizimin e veprimtarive për krijimin e atmosferës pozitive;
- mbështesë vetorganizimin e jetës së PAK-Sensor;
- mbështesë PAK- Sensor në përshtatje me situatat e reja;
- respektojë të drejtat e PAK-Sensor;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me të PAK-Sensor;
- zbatojë rregullat e etikës profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Kursanti orienton PAK-Pamor për lëvizjet me përcjellës dhe prekje sensore.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- përshkruajë teknikat për orientim dhe mobilitet të PAK-Pamor;
- përshtatë komunikimin me aftësinë e kufizuar pamore.
- përcaktojë teknikat themelore të bashkëpunimit

të PAK me përcjellësin.

- orientojë PAK-Pamor të lëvizë me përcjellësin në ambiente të ngushta.
- orientojë PAK-Pamor të lëvizë me përcjellësin në rrugë;
- orientojë PAK-Pamor me anë të prekjes sensore dhe përcjellësit për hapjen-mbylljen e dyerve dhe të ashensorit;
- orientojë PAK-Pamor me anë të prekjes sensore dhe përcjellës për zbritjen dhe ngritjen e shkallëve;
- orientojë PAK-Pamor me anë të prekjes sensore për uljen dhe ngritjen e tij/saj nga karrigia;
- të zbatojë teknikat e duhura , në mënyrë që PAK-Pamor të njohë dhe të lëvizë në mënyrë të pavarur në ambiente të ngushta;
- zbatojë teknikat e duhura , në mënyrë që PAK-Pamor të njohë dhe të lëvizë në mënyrë të pavarur në ambiente të brendshme;
- zbatojë teknikat e duhura , në mënyrë që PAK-Pamor të njohë dhe të lëvizë në mënyrë të pavarur në shkallë;
- zbatojë teknikat e duhura , në mënyrë që PAK-Pamor të njohë, të lëvizë në mënyrë të pavarur për hapjen- mbylljen e dyerve;
- zbatojë teknikat e duhura , në mënyrë që PAK-Pamor të njohë, të lëvizë në mënyrë të pavarur për përdorimin e ashensorit;
- zbatojë teknikat e duhura , në mënyrë që PAK-Pamor të njohë dhe të lëvizë në rrugë, në mjediset e jashtme;
- respektojë të drejtat e PAK-Pamor;
- të japë ndihmën e parë sipas rastit;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me PAK-Pamor;
- përkujdesen për personat me aftësi të kufizuara në banesë, pranë familjeve;
- zbatojë rregullat e komunikimit me familjarët e PAK-Pamor;
- zbatojë rregullat e etikës profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Kursanti kujdeset për përmbushjen e nevojave personale të PAK -Pamor.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- përshkruajë teknikat për orientim dhe mobilitet të PAK-Pamor;
- përshtatë komunikimin me aftësinë e kufizuar pamore;
- orientojë drejt tryezës së ngrënies PAK-Pamor;
- orientojë PAK-Pamor me anë të prekjeve sensore për gjetjen e pjatës, lugës, gotës, etj;
- asistojë gjatë ushqyerjes së PAK – Pamor;
- orientojë PAK-Pamor me anë të prekjeve sensore për njohjen e hapësirës së tualetit;
- orientojë PAK-Pamor për kryerjen e higjienës personale dhe të mjedisit;
- orientojë PAK-Pamor për gjetjen e rrobave;
- ndihmojë PAK-Pamor për ndërrimin e veshjeve;
- shoqërojë PAK-Sensor gjatë aktiviteteve kulturore dhe sociale;
- kujdeset për personat me aftësi të kufizuar pamore në banesë, pranë familjes;
- vendosë marrëdhënie të mirëkuptimit dhe besimit reciprok me PAK-Pamor dhe me familjarët e tij;
- të zbatojë rregullat e komunikimit me PAK-Pamor;
- të japë ndihmën e parë sipas rastit;
- zbatojë rregullat e etikës profesionale.

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e punës me mjetet e përshtatshme në një ambient që ofron shërbime sociale për PAK-Sensor, e simuluar, ose në instucione reale që ofrojnë shërbime rezidenciale ose ditore për PAK-Sensor.
- Instruktori dhe personeli i qendrës duhet të përfshijë sa më shumë të jetë e mundur kursantin në procedurat e përditshme konkrete të institucionit që ofron shërbimin, në situata që lidhen me nevoja specifike në rrethana specifike të PAK-Sensor.
- Instuktori dhe personeli i qendrës duhet të krijojnë kushtet e përshtatshme për kursantët në mënyrë që kursantët të simulohen në të gjitha veprimtaritë e sigurimit të nevojave psiko-sociale dhe autonomisë të PAK-Sensor.
- Kursantët duhet të angazhohen në mënyrë progresive në përkujdesjen ndaj të PAK-Sensore në zbatimin e planit të

	përkujdesit të PAK-Sensor, në vlerësimin e nevojave aktuale dhe mundësitë që ofron qendra për përmbushjen e tyre. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore. - Mjedisë reale të shërbimeve sociale PAK-Sensor. - Përsjellsa për lëvizjet e PAK-Pamor. - Komplet pjatash, tasa, gota, lugë, pirunj, thika, pipa. - Ujë, solucion larës. - Pajisjet dhe artikujt sanitarë të nevojshëm për zhveshjen, larjen, dhe veshjen e PAK-Sensore në nevojë social-shëndetësore. - Materialet ndihmëse, mjedis për zhvillimin e orëve teorike, materiale didaktike, udhëzuesa, CD, katalogë, rregullore, etj..

3. Moduli “Kujdestari për personat me aftësi të kufizuar mendore ”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KUJDESTARI PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR MENDORE.	KPAK-03-21
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i aftëson kursantët për të përmbushur nevojat psiko-sociale të PAK-Mendor, për përkujdesjen e shëndetit mendor në përshtatje me nevojat specifike PAK-Mendor, për ushqyerjen, dietën, veshjen dhe higjienën personale të PAK –Mendor sipas nevojës, si dhe dhënien e medikamenteve të rekomanduara.	
Kohëzgjatja e modulit	70 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori; 70% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar. Të jenë mbi 18 vjeç. Të kenë përfunduar Modulin 1 ”Hyrje në profesionin e kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar ”	

**Rezultatet e të
mësuarit (RM)
dhe procedurat
e vlerësimit**

RM 1 Kursanti përshkruan aftësinë e kufizuar mendore.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- përkufizojë konceptin e çrregullimit të spektrit të Autizmit;
- përcaktojë shkaqet dhe simptomat e autizmit;
- klasifikojë llojet e Autizimit;
- përshkruajë nevojat bazë të personave Autik;
- përshkruajë Sindromën Doën;
- përdorë terminologjinë që i përshatet Sindromës Doën;
- klasifikojë Sindromën Doën sipas grupmohave;
- përshkruajë çrregullimet e moshës së rritur të vonë;
- përshkruajë dhe specifikat dhe veçoritë e Sindromës Doën, sipas grupmohave;
- përshkruajë nevojat specifike të personave me çrregullimet e Dementia, Delirium, Amnezia e etj.;
- përshkruajë rregullat specifike të komunikimit me PAK – Mendor;
- përshkruajë rregullat e komunikimit me familjarët e PAK-Mendor;
- përshkruajë rreziqet e mundshme që mund të rrezikojnë jetën e PAK-Mendor;
- përshkruajë rregullat e etikës profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje -përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 2 Kursanti mbështet përmbushjen e nevojave psiko-sociale të PAK-Mendor.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të :

- kryejë vëzhgimin e PAK-mendor;
- njohë drejtpërdrejtë PAK-mendor;
- mbrojë PAK-Mendor nga paragjykimi dhe diskriminimi;
- kryejë vëzhgimin sistematik të PAK-Mendor;
- planifikojë perkujdesjen psiko-sociale sipas rasteve përkatëse;
- vlerësojë nevojat për autonomi të PAK-Mendor;
- vlerësojë nevojat sociale të PAK-Mendor;
- vlerësojë nevojat psiko-emocionale të PAK Mendor;
- vlerësojë nevojat për shoqërizim të PAK -Mendor;
- asistojë në nxitjen e fleksibilitetit gjatë rutinës së përditshme të PAK-Mendor;
- planifikojë veprimtari kreative;
- mbështesë vetorganizimin e jetës së PAK-Mendor;

- mbështesë PAK- Mendor në përshatje me situatat e reja;
- përmbushë nevojat e PAK-Mendor;
- respektojë të drejtat e PAK-Mendor;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me PAK-Mendor.
- raportojë te familjarët dhe mjeku gjendjen shëndetësore dhe rastet e abuzimit të PAK-Mendor;
- përkujdesen për personat me aftësi të kufizuar në banesë, pranë familjeve;
- zbatojë rregullat e komunikimit me familjarët e PAK-Mendor.
- zbatojë rregullat e etikës profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Kursanti kujdeset për shëndetin mendor të PAK-Mendor.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- përforcojë sjellje pozitive të PAK-Mendor;
- shmangë sjelljet negative të PAK-Mendor;
- përdorë empatinë ndaj PAK-Mendor;
- trajtojë me dinjitet PAK-Mendor;
- kujdeset për edukimin dhe cilësinë e jetës PAK - Mendor;
- komunikojë me empati dhe etikë profesionale me PAK-Mendor;
- shoqërojnë PAK-Mendor gjatë aktiviteteve kulturore dhe sociale;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me PAK-Mendor.
- zbatojë rregullat e komunikimit me familjarët e PAK-Mendor.
- zbatojë rregullat e etikës profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Kursanti kujdeset për ushqyerjen, dietën, veshjen dhe higjienën personale të PAK –Mendor.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- përshkruajë nevojat personale të PAK – Mendor;
- komunikojë me empati me PAK – Mendor;
- mbështesë PAK-Mendor për kujdesin e higjienës personale;

- pastrojë dhe të kujdeset për tualetin dhe higjienën personale të PAK-Mendor, sipas nevojës;
- asistojë në ushqyerjen e PAK-Mendor;
- kujdeset për dietën dhe ushqyerjen e PAK-Mendor sipas nevojës;
- kujdeset për gjumin normal dhe të rregullt të PAK-Mendor;
- asistojë në veshjen e PAK-Mendor, sipas nevojës;
- të garantojë ambjent të sigurtë për PAK-Mendor;
- kujdeset për shëndetin dhe mirëqënien fizike të PAK-Mendor;
- zbatojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit;
- kujdeset për rreziqet e papritura;
- të jap ndihmën e parë sipas nevojës PAK-Mendor;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me të PAK-Mendor;
- të përkujdesen për personat me aftësi të kufizuara në banesë, pranë familjes;
- zbatojë rregullat e komunikimit me familjarët e PAK-Mendor;
- zbatojë rregullat e etikës profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 5 Kursanti ndihmon PAK-Mendor për marrjen e medikamenteve të rekomanduara nga mjeku.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- të zbatojë rekomandimet e mjekut për dhënien e medikamenteve;
- lexojë me përpikmëri formën dhe dozimin;
- zbatojë me korrektësi mënyrën e përdorimit të barnave;
- sqarojë PAK-Mendor në nevojë në rast paqartësie;
- kryejë identifikimin dhe reagimin në rast të efekteve të padëshiruara të barnave;
- zbatojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit;
- kujdeset për rreziqet e papritura;
- të jap ndihmën e parë sipas nevojës PAK-Mendor;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me PAK-Mendor;
- përkujdesen për personat me aftësi të kufizuara në banesë, pranë familjeve;
- zbatojë rregullat e komunikimit me familjarët e PAK-Mendor;
- zbatojë rregullat e etikës profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e punës me mjetet e përshtatshme në një ambient që ofron shërbime sociale për PAK-Mendor, e simuluar, ose në instucione reale që ofrojnë shërbime rezidenciale ose ditore për PAK-Mendor. - Instruktori duhet të zotërojë dhe instruktojë në mënyrë sa më të saktë të gjitha etapat e përgatitjes dhe dhënies së ushqimit, respektimit të dietës, sipas rekomandimeve nga mjeku. - Instruktori duhet të zotërojë dhe instruktojë në mënyrë sa më të saktë të gjitha etapat e përgatitjes dhe kujdesit për higjienën personale - Instruktori duhet të kryejë demonstrime të sakta praktike për zhveshjen, larjen dhe veshjen e PAK-Mendor, sipas nevojës dhe moshës, sidomos për çrregullimet e moshës së rritur të vonë. - Kursanti duhet të përfshihet sa më shumë gjatë praktikimit të proësisë të ushqyerjes dhe të zhveshjes, larjes dhe veshjes së PAK-Mendor, fillimisht duke ndihmuar deri në realizimin e plotë prej tij, të kujdesit të higjienës personale. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i praktikimit të shprehive dhe aftësive të fituara. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Kabinet i kujdesit social-shëndetësor, shtëpi për PAK-Mendor, etj.. - Komplet pjatash, tasa, gota, lugë, pirunj, thika, pipa. - Peceta, peshqirë, tavolina shtrati, jastëk etj. - Ujë, solucion larës. - Pajisjet dhe artikujt sanitarë të nevojshëm për zhveshjen, larjen, dhe veshjen e PAK-Mendore në nevojë social-shëndetësore. - PAK-Mendore sipas moshave, në nevojë social-shëndetësore ose manekinë. - Udhëzues, rregullorë, etj.

4. Moduli “Kujdestari për personat me aftësi të kufizuar fizike”.

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	KUJDESTARI PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR FIZIKE.	KPAK-04-21
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i aftëson kursantët për të përmbushur nevojat psiko-sociale të PAK-Fizik, për përkujdesjen e shëndetit mendor në përshtatje me nevojat specifike PAK-Fizik, për ushqyerjen, dietën, veshjen dhe higjienën personale, dhënien e medikamenteve të PAK –Fizik, si dhe për zbatimin e gjimnastikës dhe procedurave të rekomanduara.	
Kohëzgjatja e modulit	80 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori; 70% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar. Të jenë mbi 18 vjeç. Të kenë përfunduar Modulin 1 “Hyrje në profesionin e kujdestarit për personat me aftësi të kufizuar”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan aftësinë e kufizuar fizike. Kriteret e vlerësimit: - Kursanti duhet të jetë i aftë të: - përshkruajë llojet e aftësisë së kufizuar fizike - përshkruajë shkaqet e paraplegjisë, tetraplegjisë; - përshkruajë komplikacionet e paraplegjisë, tetraplegjisë; - përshkruajë nevojat specifike të paraplegjisë, tetraplegjisë; - përshkruajë paralizat e tjera si: dilpegjia, hemiplegjia, triplegjia, monolpegjia, amputacioni, hipotonia muskulare; - të përshkruajë komplikacionet e dilpegjisë, hemiplegjisë, triplegjisë, monolpegjisë, amputacionit, hipotonisë muskulare; - përshkruajë nevojat specifike të PAK me paraliza të tjera si: dilpegjia, hemiplegjia, triplegjia, monolpegjia, amputacioni, hipotonia muskulare; - përshkruajë rregullat e raportimit për gjendjen e PAK-Fizik; - përshkruajë rregullat specifike të komunikimit me PAK –Fizik; - përshkruajë rregullat e komunikimit me familjarët e PAK-Fizik; - përshkruajë rreziqet e mundshme që mund të rezikojnë jetën e PAK-Fizik; - të përshkruajë rregullat e etikës profesionale. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli	

RM 2 Kursanti mbështet përmbushjen e nevojave psiko-sociale të PAK-Fizik.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të :

- njohë drejtpërdrejtë PAK- Fizik;
- mbrojë PAK- Fizik nga paragjykimi dhe diskriminimi;
- vëzhgojë sistematikisht PAK- Fizik;
- planifikojë përkujdesjen psiko-sociale sipas rasteve përkatëse;
- vlerësojë nevojat sociale të PAK- Fizik;
- vlerësojë nevojat psiko-emocionale të PAK Fizik;
- vlerësojë nevojat për shoqërizim të PAK - Fizik;
- vlerësojë nevojat për autonomi të PAK- Fizik;
- asistojë në nxitjen e fleksibilitetit gjatë rutinës së përditshme të PAK- Fizike;
- planifikojë veprimtari kreative;
- mbështesë vetorganizimin e jetës së PAK- Fizik;
- mbështesë PAK- Fizik në përshatje me situatat e reja;
- respektojë të drejtat e PAK- Fizik;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me PAK- Fizik;
- raportojë te familjarët dhe mjeku gjendjen shëndetësore dhe rastet e abuzimit të PAK- Fizike;
- përkujdesjen për personat me aftësi të kufizuar në banesë, pranë familjeve;
- zbatojë rregullat e komunikimit me famijarët e PAK- Fizik;
- zbatojë rregullat e etikës profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Kursanti përkujdeset për shëndetin mendor të PAK-Fizik.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- bashkëbisedojë me PAK-Fizik;
- përdorë empatinë gjatë komunikimit me PAK-Fizik;
- trajtojë me dinjitet PAK-Fizik;
- kujdeset për edukimin dhe cilësinë e jetës PAK - Fizik;
- shoqërojnë PAK-Fizik gjatë aktiviteteve kulturore dhe sociale;
- kryejë veprimtari kreative me PAK-Fizik;
- shoqërojnë PAK-Fizik gjatë fizioterapisë;
- trajtojë PAK-Fizik sipas moshës dhe stausit social;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me të PAK- Fizik;
- përkujdeset për personat me aftësi të kufizuar në

banesë, pranë familjeve;

- zbatojë rregullat e komunikimit me famijarët e PAK-Fizik;
- zbatojë rregullat e etikës profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Kursanti kujdeset për ushqyerjen, veshjen dhe higjienën personale të PAK -Fizik.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- përshkruajë nevojat personale të PAK – Fizik;
- komunikojë me empati me PAK – Fizik;
- ndihmojë PAK-Fizik për kujdesin e higjienës personale;
- pastrojë dhe të kujdeset për tualetin dhe higjienën personale të PAK-Fizik, sipas nevojës;
- zbatojë masat higjienike personale dhe intime;
- asistojë në ushqyerjen e PAK-Fizik;
- ushqejë PAK-Fizik sipas nevojës;
- kujdeset për gjumin normal dhe të rregullt të PAK-Fizik
- kujdeset për veshjen dhe zhveshjen e PAK-Fizik, sipas nevojës;
- të garantojë ambjent të sigurtë për PAK-Fizik;
- kujdeset për shëndetin fizik të Pak- Fizik;
- zbatojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit;
- kujdeset për rrëziqet e papritura;
- japë ndihmën e parë sipas nevojës PAK-Fizik;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me PAK-Fizik;
- përkujdeset për personat me aftësi të kufizuar në banesë, pranë familjes;
- zbatojë rregullat e komunikimit me famijarët e PAK-Fizike;
- zbatojë rregullat e etikës profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 5 Kursanti zbaton gjimnastikën dhe procedurat e rekomanduara në varësi të aftësisë së kufizuar fizike.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- përdorë kompresë të ftohta dhe të ngrohta sipas rekomandimeve nga mjeku;
- përdorë fashaturat sipas rekomandimeve nga mjeku;
- kryejë identifikimin e efekteve të pa dëshiruara të procedurave të rekomanduara;
- kryejë masazhimin e gjymtyrëve gjatë larjes;

- kryerë lëvizje të plota të kyçeve gjatë larjes dhe gjatë përgatitjes së shtratit sipas rekomandimeve;
- kryejë lëvizje aktive izometrike dhe izotonike sipas rekomandimeve;
- kontrollojë gjendjen shpirtërore, pulsën dhe frymëmarrjen;
- zbatojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit;
- jap ndihmën e parë sipas nevojës dhe rasteve që përbëjnë rrezik për PAK-Fizik;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me PAK-Fizik;
- përkujdesen për personat me aftësi të kufizuara në banesë, pranë familjes;
- zbatojë rregullat e komunikimit me familjarët e PAK-Fizik.
- zbatojë rregullat e etikës profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 6 Kursanti ndihmon PAK-Fizik për marrjen e medikamenteve të rekomanduara nga mjeku.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- komunikojë me empati me PAK – Fizik;
- zbatojë rekomandimet e mjekut për dhënien e medikamenteve;
- lexojë me përpikmëri formën dhe dozimin;
- zbatojë me korrektësi mënyrën e përdorimit të barnave;
- sqarojë PAK-Fizik në nevojë në rast paqartësie;
- kryejë identifikimin dhe reagimin në rast të efekteve të padëshiruara të barnave;
- kujdeset për rreziqet e papritura;
- jap ndihmën e parë sipas nevojës PAK-Fizik;
- zbatojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit;
- zbatojë rregullat specifike të komunikimit me PAK-Fizik;
- përkujdesen për personat me aftësi të kufizuara në banesë, pranë familjes;
- zbatojë rregullat e komunikimit me familjarët e PAK-Fizik;
- zbatojë rregullat e etikës profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e punës me mjetet e përshtatshme në një ambient që ofron shërbime sociale për PAK-Fizik, e simuluar, ose në instancione reale që ofrojnë shërbime rezidenciale ose ditore për PAK-Fizik.
- Instruktori duhet të zotërojë dhe instruktojë në mënyrë sa

më të saktë të gjitha etapat e përgatitjes dhe dhënies së ushqimit, respektimit të dietës, ndihmën e parë, sipas rekomandimeve nga mjeku.

- Instruktori duhet të zotërojë dhe instruktojë në mënyrë sa më të saktë të gjitha etapat e përgatitjes dhe kujdesit për higjienën personale.
- Instruktori duhet të kryejë demonstrime të sakta praktike për zhveshjen, larjen dhe veshjen e PAK-Fizik, sipas nevojës dhe moshës, sidomos për moshën e tretë.
- Kursanti duhet të përfshihet sa më shumë gjatë procesit të ushqyerjes dhe të zhveshjes, larjes dhe veshjes së PAK-Fizik, fillimisht duke ndihmuar deri në realizimin e plotë prej tij të gjithë procesit të ushqyerjes, veshjes dhe kujdesit të higjienës personale, të zbatimit të proceduarve të rekomanduara.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive dhe aftësive të fituara. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet mjedisi, individët në mosha të ndryshme, pajisjet dhe materialet si më poshtë:

- Kabinet kujdesi social-shëndetësor, shtëpi për PAK-Fizik, etj..
- Komplet pjatash, tasa, gota, lugë, pirunj, thika, pipa.
- Peceta, peshqirë, tavolina shtrati, jastëk etj.
- Ujë, solucion larës.
- Pajisjet dhe artikujt sanitarë të nevojshëm për zhveshjen, larjen, dhe veshjen e PAK-Fizik në nevojë social-shëndetësore.
- Karrige me rrota për personat me aftësi të kufizuar fizike.
- PAK-Fizik sipas moshave, në nevojë social-shëndetësore ose manekinë.
- Spitale, klinika, shtëpi për të moshuar, etj.
- Materialet ndihmëse për përkujdesje dhe artikuj sanitarë
- Udhëzues, katalogë, rregullore, etj